

Vendim nr. 111 datë 20.05.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Fiona Papajorgji, anëtarë, në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (V) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **VIKTOR BAJRAKTARI (YMERI)**, përfaqësuar nga avokatët Rabiana Halili dhe Sokol Mëngjesi, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1717 (282), datë 31.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, pika 1, 29, pika 3, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetutën); nenet 6, pika 1 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, pikat 1 e 2, 71/1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi bazën e ngjarjes së datës 28.06.1999, ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasit Viktor Ymeri (*kërkuesi*) dhe të disa shtetasve të tjerë për veprat penale “Vrasja me paramendim”, e kryer në bashkëpunim, të shtetasit A.P., “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të shtetasit I. Xh., “Mbajtja pa leje e armëve, municioneve e fishekëve luftarakë”, “Dhunimi i banesës” dhe “Përdorimi i pasaportave të falsifikuara”, të parashikuara nga nenet 78, 78, 25, 25, 278, pikat 2 e 3 dhe 189/1 të Kodit Penal (KP). Në vijim, organi i akuzës ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kërkesën për gjykim për kërkuesin dhe shtetasin G.B., të cilët ishin të arrestuar që në datën 29.06.2000.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 175, datë 24.07.2000, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të shtetasit I. Xh. dhe në bazë të neneve 78, 25, 50, shkronjat “a” dhe “gj”, të KP-së, dënimin e tij me burgim të përjetshëm; deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të shtetasit A. P. dhe në bazë të neneve 78, 25, 50, shkronjat “a” dhe “gj”, të KP-së, dënimin e tij me burgim të përjetshëm; deklarinimin fajtor të tij për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve, municioneve e fishekëve luftarakë” dhe në bazë të nenit 278, pikat 2 dhe 3, të KP-së, dënimin e tij me 3 vjet burgim; deklarinimin e tij të pafajshëm për veprën penale “Dhunimi i banesës”, në zbatim të nenit 388, shkronja ‘b’, të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të KP-së, kërkuesi është dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 58, datë 15.03.2001, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 505, datë 28.09.2001, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit dhe të të pandehurit G.B. si të pabazuar në ligj.

4. Në datën 05.11.2012 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke pretenduar se pas dhënies së tij janë zbuluar prova të reja dhe se këto prova bashkë me ato të vlerësuara një herë në gjykimet e mëparshme faktojnë se vendimi i dënimin të tij ishte i gabuar. Për këtë qëllim kërkuesi ka paraqitur aktin e interpretimit të ekspertimit biologjik të kryer gjatë procesit, sipas të cilit rezulton se profili i ADN-së së gjetur në njollën e gjakut të xhinseve të kërkuesit nuk përputhej në 3 lokuse me profilin e ADN-së së tij.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 179, datë 28.10.2015, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim të kërkuesit, prishjen e vendimeve të të tria shkallëve, si dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, me tjetër trup gjykues, me

arsyetimin se prova e paraqitur nga kërkuesi ishte provë e re dhe thelbësore në kuptim të ligjit, e cila nuk rezultonte të ishte marrë në shqyrtim në gjykimin penal të zhvilluar kundër tij. Sipas Kolegjit Penal, meqenëse akti i ekspertimit i datës 29.10.2012, i kryer gjatë gjykimit, vihej në dyshim nga prova e re e paraqitur me kërkesën për rishikim, konsiderohej e nevojshme që kjo provë t'i nënshtrohej shqyrtimit nëpërmjet debatit gjyqësor dhe të vlerësohej së bashku me provat e tjera.

6. Në procesin e rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2017-3220) 450, datë 23.06.2017, ka vendosur deklarin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit I.Xh. dhe në bazë të neneve 78 dhe 25 të KP-së dënimin e tij me burgim të përjetshëm; deklarin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit A.P. dhe në bazë të neneve 78 dhe 25 të KP-së dënimin e tij me burgim të përjetshëm; deklarin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit” dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, sipas nenit 55 të KP-së, gjykata ka vendosur dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se prova e re nuk çonte në pafajësinë e të dënuarit dhe se ishte vendi për të konfirmuar përfundimet e arritura në vendimet gjyqësore të themelit objekt rishikimi dhe se nuk kishte vend për zbatimin e dispozitës penale favorizuese (neni 3, pika 3, i KP-së) ndaj kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

7. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.10-2018-1993 (444), datë 31.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me këto ndryshime: (i) dënimin e kërkuesit sipas neneve 78/1 e 25 të KP-së për vrasjen e shtetasit I.Xh. me 25 vjet burgim; (ii) dënimin e tij sipas neneve 78/1 e 25 të KP-së për vrasjen e shtetasit A.P. me 25 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të KP-së, dënimin e kërkuesit përfundimisht me 25 vjet burgim. Për sa i përket ligjit penal të aplikueshëm, gjykata e apelit ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur nuk ka zbatuar nenin 3, pika 3, të KP-së ndaj kërkuesit, pasi pozita procedurale e këtij shtetasi vërtet nuk kishte ndryshuar, por pranimi i kërkesës së tij për rishikimin e vendimit penal sillte futjen e gjykimit me procedurë të zakonshme, duke i dhënë atij të drejtën e ankimit dhe të kontrollit gjyqësor nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit, referuar kjo edhe në vendimin unifikues nr. 3, datë 08.07.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 3/2013*). Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1717 (282), datë 31.10.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me arsyetimin se vendimi i gjykatës së apelit ishte marrë në zbatim të gabuar të ligjit penal, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë ka mbajtur në vëmendje të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë institutin e së drejtës së rishikimit, si mjet ankimi i jashtëzakonshëm dhe përjashtimor kundër një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë, si dhe praktikën gjyqësore të unifikuar dhe jurisprudencën kushtetuese, në të cilat qartësohej procedura që duhej të ndiqej dhe mënyra e vlerësimit të provave në fazën e gjykimit të rishikimit.

9. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në datën 28.02.2024, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të marrë në kuadër të procesit të rishikimit. Në datën 03.05.2024 Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa dijeninë e tij, për shkak se ai nuk është njoftuar për ditën dhe orën e gjykimit. Duke qenë i paraburgosur që prej muajit dhjetor të vitit 2019 në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*) nr. 302, ai ka qenë në pamundësi për të verifikuar afishimet në këndin e njoftimeve dhe në faqen elektronike të kësaj gjykate. Avokati i tij mbrojtës, pjesëmarrës në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e apelit në vitin 2018, nuk ka pasur dijeni për rekursin e bërë nga prokuroria e apelit, pasi nuk është njoftuar nga Gjykata e Lartë, si dhe nuk ka pasur më kontakte as me kërkuesin. Edhe pse në dëftesën e komunikimit të rekursit të dërguar nga Gjykata e Lartë rezulton se ai e ka nënshkruar atë dhe si rrjedhim ka marrë dijeni për rekursin, në bazë të aktit të ekspertimit nr. 2, datë 19.01.2024 të ekspertit kriminalist të licencuar, rezulton se nënshkrimi i tij është falsifikuar, fakt për të cilin, në datën 26.01.2024, ai ka depozituar kallëzim në prokurori.

- 10.1.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe asaj për t'u mbrojtur*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pasur detyrimin ligjor ta shqyrtonte rekursin në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pasi e vetmja mundësi procedurale e kërkuarit për t'u mbrojtur, në kushtet kur rekursues është organi i akuzës dhe paraqitja e pretendimeve në seancë gjyqësore. Mosnjoftimi i kërkuarit nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit i ka cenuar atij të drejtën për t'u mbrojtur përmes paraqitjes së parashtrimeve të tij përpara gjykatës, në kushtet kur në kohën e depozitimit të rekursit nuk parashikohej ligjërisht mundësia e paraqitjes së kundërrekursit si mjet procedural. Prokuroria e apelit ka ngritur në rekurs pretendime të natyrës kushtetuese, për sa i përket zbatimit të garancive kushtetuese e procedurale penale, sikurse është neni 29, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 3, pika 3, i KP-së, si dhe ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Në këto rrethana, çështja duhet të ishte gjykuar në prani të palëve, në seancë gjyqësore dhe kjo gjykatë duhet të dëgjonte parashtrimet e kërkuarit të përfaqësuar nga avokati i tij mbrojtës.
- 10.1.3. *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, si pasojë e vendimmarrjes së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- 10.1.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një gjykim haptazi të pabarabartë, duke shkaktuar cenimin e së drejtës së mbrojtjes si pasojë e moskryerjes së njoftimit të kërkuarit dhe mbrojtësit të tij për rekursin e ushtruar nga prokuroria e apelit.
- 10.1.5. *Së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.12.2018 dhe vendimi është marrë në datën 31.10.2023, pra pas më shumë se 5 vjetësh, ndërkohë që çështja duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti. Kërkuari nuk është bërë shkak për vonesa ose për zvarritjen e procesit, përkundrazi, as nuk është njoftuar për zhvillimin e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë. Po kështu, kjo çështje nuk paraqet rrethana veçanërisht të vështira ose komplekse që të mund të justifikonte vonesën në shqyrtimin e saj. Lidhur me sjelljen e autoriteteve, sikurse është pohuar edhe në jurisprudencën kushtetuese,

reforma në drejtësi nuk mund të justifikojë vonesat në gjykimin e çështjeve, pasi shteti është i detyruar të marrë masa për shmangien e tejzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve në pritje.

10.2. *E drejta e barazisë përpara ligjit*, e garantuar nga neni 18 i Kushtetutës si pasojë e vendimmarrjes së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

10.3. *Parimi i fuqisë prapavepruese i ligjit penal favorizues*, i garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej të kishte lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, ku ishin zbatuar në mënyrë korrekte neni 29, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 3, pika 3, i KP-së, për sa i përket fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, në kushtet kur dispozita penale në momentin e gjykimit ka qenë favorizuese ndaj kërkuesit, për sa i përket masës së dënimit. Në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), ky kolegji ka argumentuar se rishikimi është proces i jashtëzakonshëm dhe zbatimi i ligjit penal favorizues nuk mund të shërbejë për vënien në lëvizje të këtij mjeti ankimi, pasi procesi i rigjykimit nuk është mbështetur në zbatimin e ligjit penal favorizues, por në provën e ekspertimit të datës 29.10.2012.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen

njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë ndaj të cilit ka ngritur pretendime dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këtë drejtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi çështja ishte regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.12.2018 dhe vendimi është marrë në datën 31.10.2023, pra pas më shumë se 5 vjetësh, ndërkohë që çështja duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti.

15. Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se ai duhet t’i shfrytëzojë ato përpara se t’i drejtohet asaj (*shih vendimin nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi i ka pasur të gjitha mundësitë t’i drejtohej Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës së saj, ndërkohë që rezulton se ai nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë të tillë sipas parashikimeve të neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, për këtë pretendim kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive, prandaj nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesi në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës për t’u dëgjuar dhe asaj për t’u mbrojtur, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, të garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, janë pretendime që lidhen me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Lartë, i cili ka

përmyllur procesin gjyqësor në kuadër të rishikimit të çështjes. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se për këto pretendime ai e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 31.10.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 28.02.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Si rrjedhim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës për t’u dëgjuar dhe asaj për t’u mbrojtur, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës. Ai ka pretenduar, gjithashtu, edhe cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, si dhe parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, të garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, pretendime të cilat së bashku me të drejtën për proces të rregullt ligjor *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës

19. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, si dhe atij të *sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi është mjaftuar vetëm me përmendjen e tyre, pa paraqitur ndonjë argument konkret në lidhje me to. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim, pasi nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese.

20. Në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, bazuar në thelbin e argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson që të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, si dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit t’i analizojë së bashku.

21. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve do të analizojë në vijim pretendimet e kërkuesit në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të: (i) së drejtës për t’u njoftuar; (ii) së drejtës për t’u dëgjuar, së drejtës për t’u mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit; (iii) si dhe parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, të garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës.

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u njoftuar

22. Kërkuesi ka pretenduar se gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa dijeninë e tij, për shkak se ai nuk është njoftuar për ditën dhe orën e gjyqimit. Duke qenë i paraburgosur që prej muajit dhjetor të vitit 2019 në IEVP-në nr. 302, ai ka qenë në pamundësi për të verifikuar afishimet në këndin e njoftimeve dhe në faqen elektronike të kësaj gjykate. Avokati i tij mbrojtës, pjesëmarrës në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e apelit në vitin 2018, nuk ka pasur dijeni për rekursin e bërë nga prokuroria e apelit, pasi nuk është njoftuar nga Gjykata e Lartë, si dhe nuk ka pasur më kontakte as me kërkuesin. Edhe pse në dëftesën e komunikimit të rekursit të dërguar nga Gjykata e Lartë rezulton se ai e ka nënshkruar atë në bazë të aktit të ekspertimit nr. 2, datë 19.01.2024 të ekspertit kriminalist të licencuar, rezulton se nënshkrimi i tij ishte falsifikuar, fakt për të cilin, në datën 26.01.2024, ai ka depozituar kallëzim në prokurori.

23. Në jurisprudencën kushtetuese, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. E drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22 datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në rastin në shqyrtim procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se kërkuesi është njoftuar për rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, çka provohet me dëftesën e komunikimit të nënshkruar nga vetë ai në datën 07.12.2018, në mjediset e IEVP-së Peqin. Prandaj, në kundërshtim me sa pretendohet nga kërkuesi, pavarësisht se në momentin e ushtrimit të rekursit ka qenë duke vuajtur dëmin penal në IEVP-në, Peqin, ai është vënë në dijeni të faktit se subjekti i interesuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs.

25. Po kështu, edhe mbrojtësit ligjor të kërkuesit i është dërguar njoftim për rekursin dhe dëftesa e komunikimit e datës 07.12.2018 rezulton e nënshkruar nga ana e tij. Edhe pse prej tij pretendohet se nënshkrimi i tij në dëftesën e komunikimit ishte i falsifikuar, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se çështja ndodhet nën hetim nga organi i akuzës dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar për të. Gjithsesi ky fakt nuk përbën rëndësi në aspektin kushtetues të çështjes objekt shqyrtimi, për

sa kohë që vetë kërkuesi është njoftuar rregullisht individualisht për rekursin e ushtruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës në Gjykatën e Lartë.

26. Gjithashtu, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë dhe aktet e dosjes gjyqësore, rezulton se në datën 20.09.2023 është shpallur lista e çështjeve penale për shqyrtim në dhomën e këshillimit në Kolegjin Penal në datën 24.10.2023, ora 11:40, gjykim i cili është shtyrë për në datën 31.10.2023, ora 11:40, përmes një njoftimi të dytë të bërë nga kjo gjykatë. Kjo do të thotë se sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka njoftuar me shpallje datën dhe orën e seancës në dhomën e këshillimit, të paktën 30 ditë përpara zhvillimit të saj. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar është haptazi i pabazuar.

B.2. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

27. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pasur detyrimin ligjor ta shqyrtonte rekursin në seancë gjyqësore me praninë e palëve, pasi e vetmja mundësi procedurale e kërkuesit për t'u mbrojtur, në kushtet kur rekursues ishte organi i akuzës, ishte paraqitja e pretendimeve në seancën gjyqësore. Mosnjoftimi i kërkuesit nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit i ka cenuar atij të drejtën për t'u mbrojtur përmes paraqitjes së parashtrimeve të tij përpara gjykatës, në kushtet kur në kohën e depozitimit të rekursit nuk parashikohej nga ligji mundësia e paraqitjes së kundërrekursit si mjet procedural. Prokuroria e apelit ka ngritur në rekurs pretendime të natyrës kushtetuese, për sa i përket zbatimit të garancive kushtetuese e procedurale penale, sikurse është neni 29, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 3, pika 3, i KP-së, si dhe ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Në këto rrethana, çështja duhej të ishte gjykuar në prani të palëve, në seancë gjyqësore dhe kjo gjykatë duhej të dëgjonte parashtrimet e kërkuesit të përfaqësuar nga avokati i tij mbrojtës.

28. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se drejta për t'u dëgjuar është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore, në kuptim edhe të parimit të barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar nuk nënkupton vetëm atë për t'u paraqitur personalisht përpara organit të pushtetit publik, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, nëpërmjet komenteve dhe shpjegimeve të dhëna me shkrim (*shih vendimet nr. 1, datë 16.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Kur në Gjykatën e Lartë janë vënë në diskutim çështje ligji, për të cilat palët nuk kanë dhënë më parë mendimin e tyre, Gjykata është shprehur se palëve duhet t'u jepet mundësia të paraqesin paraprakisht mendimin e tyre për çështjet ligjore të analizuara kryesisht nga ajo gjykatë në mënyrë që t'u garantohet efektivisht e drejta e aksesit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 13 datë 21.03.2023; nr. 7 datë 21.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesit i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur (*shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nisur nga sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë vënë në diskutim çështje të ligjit, për sa i përket zbatimit të nenit 29, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 3, të KP-së, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësinë të debatonin ose të jepnin mendimin e tyre më parë. Pavarësisht formës së shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kjo mënyrë e zhvillimit të seancës gjyqësore mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar, përkundrazi, në këto raste debati i palëve realizohet njësoj, pavarësisht formës së paraqitjes së argumenteve me shkrim, pra përmes shkëmbimit respektiv dhe në kohën e duhur të parashtrimeve, prapësimeve dhe provave dokumentare të paraqitura, të cilave Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje, duke vlerësuar shkaqet dhe bazueshmërinë e tyre në themel (*shih vendimin nr.41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se gjykimi në gjykatat e faktit (në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit) është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, pra me praninë e palëve, gjatë të cilave

kërkuesi që përfaqësohej me mbrojtës ligjor të zgjedhur vetë, ka pasur mundësi të merrte pjesë dhe të jepte vlerësimin e tij për çështjet e ligjit.

32. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit se si pasojë e mosnjoftimit të tij nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit i është cenuar e drejta për t'u mbrojtur përmes paraqitjes së parashtrimeve të tij përpara gjykatës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, ashtu sikurse u theksua edhe më lart (*shih paragrafët 24, 25 dhe 26 të vendimit*) kërkuesi është njoftuar rregullisht për rekursin e paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe sekretaria e Gjykatës së Lartë i ka njoftuar me shpallje datën dhe orën e seancës në dhomën e këshillimit, të paktën 30 ditë përpara zhvillimit të saj. Në këtë kuptim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi i ka pasur të gjitha mundësitë për të paraqitur parashtrimet e tij në Gjykatën e Lartë përmes avokatit të zgjedhur nga ai vetë.

33. Në këtë kontekst, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka vepruar në shkelje të dispozitave procedurale të zbatueshme, për sa i përket gjykimit në dhomën e këshillimit dhe as të ketë vënë kërkuesin në pozita të pabarabarta me palën tjetër në gjykim.

34. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

B.3. Për pretendimin e cenimit të parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues

35. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej të kishte lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, ku ishte zbatuar në mënyrë korrekte neni 29, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 3, pika 3, i KP-së, për sa i përket fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, në kushtet kur dispozita penale në momentin e gjykimit ka qenë favorizuese ndaj kërkuesit në lidhje me masën e dënimit. Në kundërshtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, ky kolegji ka argumentuar se rishikimi është proces i jashtëzakonshëm dhe zbatimi i ligjit penal favorizues nuk mund të shërbejë për vënien në lëvizje të këtij mjeti ankimi. Sipas kërkuesit, në kundërshtim me sa arsyeton Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, zbatimi i nenit 3, pika 3, të KP-së nuk përbënte asnjë pengesë ligjore.

36. Në lidhje me zbatimin e ligjit penal favorizues, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si e tillë, është e rëndësishme për respektimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor. Ky parim gjen zbatim vetëm për ligjet penale, arsye për të cilën dispozita kushtetuese reflektohet në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur

është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale (*shih vendimet nr. 2, datë 15.02.2017; nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar menjëherë nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pasi çështja është gjykuar përfundimisht nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk ka më vend për aplikimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Në këto kushte, ai nuk mund të përbëjë as shkak për rishikimin e çështjes nga këto gjykata (*shih vendimet nr. 49 datë 03.07.2017; nr. 14, datë 17.04.2007; nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Për sa i takon rishikimit të vendimit të formës së prerë, Gjykata ka pohuar se rishikimi përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimet nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 74, datë 16.12.2016; nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 36, datë 26.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Edhe GJEDNJ-ja, duke interpretuar nenin 7 të KEDNJ-së në lidhje me zbatimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, nuk ka konstatuar ndonjë arbitraritet ose paarsyeshmëri të dukshme në përfundimet e arritura nga gjykatat vendase kur ato kanë disponuar se ligji penal favorizues nuk mund të shërbejë si bazë për rishikimin e çështjes së kërkuarit (*shih Artsruni kundër Armenisë, aplikimi nr. 41126/13, datë 30.11.2021, §§ 56, 60*). Ndërsa pas rihapjes së procesit në vijim të një vendimmarrjeje po të GJEDNJ-së, ajo është shprehur se nuk mund të konsiderohet se Gjykata e Lartë ka vendosur një dënim të ri ndaj ankuesit (*shih Shabelnik kundër Ukrainës nr. 3, aplikimi nr. 54806/18, datë 04.11.2021, §§ 48, 49*).

39. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuari është dënuar për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Vrasja me paramendim, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 78, 78 e 25 të KP-së, si në procesin e themelit, ashtu edhe në procesin e rishikimit të vendimit të formës së prerë. Kjo dispozitë, në kohën e kryerjes së veprës penale nga kërkuari në datën 29.06.1999, parashikonte se vrasja e kryer me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet dhe, kur ka rrethana rënduese, me burgim të përjetshëm. Me ndryshimet që i janë bërë kësaj dispozite me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 “Për

disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr.8733/2001) (neni 10), me ligjin nr. 9686, datë 26.02.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”(ligji nr. 9686/2007) (neni 7), si dhe me ligjin nr. 144, datë 02.05.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr. 144/2013) (neni 14), ajo, në kohën e rigjykimit të kërkuesit, ka ndryshuar duke parashikuar se vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet, ndërsa vrasja e kryer për interes ose për hakmarrje dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

40. Në rastin objekt shqyrtimi, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se pas pranimit të kërkesës për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka çmuar se, në rastin konkret, nuk ndryshon përfundimi në lidhje me fajësinë e të dënuarit, pasi prova e re, e marrë dhe e nënshtruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk çon në pafajësinë e tij, ndaj në këtë rast nuk ka mundësi tjetër vendimmarrjeje. Në vijim të kësaj linje arsyetimi, ajo ka çmuar, gjithashtu, se nuk ka vend për zbatimin e ligjit penal favorizues. Sipas saj, as Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit të tij për çështjen në themel nuk e ka zbatuar parashikimin e dispozitës penale favorizuese për kërkuesin, edhe pse ndryshimet e nenit 78 të KP-së kanë qenë në fuqi në momentin e gjykimit të rekursit. Po sipas gjykatës së shkallës së parë, kjo kupton se Gjykata e Lartë i ka gjetur të drejta vendimet e gjykatave më të ulëta, si në fajësinë e kërkuesit, ashtu edhe në ligjin e zbatuar. Argumentimi i saj është mbështetur edhe në qasjen ndaj vendimit unifikues nr. 4/2003, sipas të cilit fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues zbatohet vetëm si përjashtim, kur ligji i ri nuk e konsideron më si veprë penale, veprën për të cilën është dënuar kërkuesi, ndërkohë që rasti konkret nuk është i tillë. Po kështu, ajo ka arsyetuar se në gjykimin fillestar vendimmarrja e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është mbështetur në parashikimin e dispozitës së mëparshme, pasi ato kanë çmuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale me paramendim, në bashkëpunim dhe në rrethana rënduese, duke i dhënë dënimin përkatës. Për këtë arsye, ajo ka vlerësuar se nuk ka vend për zbatimin e ligjit penal aktual (*shih faqet 11 dhe 12 të vendimit nr. (11-2017-3220) 450, datë 23.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës*).

41. Pas shqyrtimit gjyqësor të ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se prova e re, në harmoni me provat e tjera që janë vlerësuar më parë në gjykimin fillestar, nuk çon në një vendimmarrje tjetër të kësaj gjykate dhe se interpretimi i saj nuk provon fakte të kundërta nga ato të parashtruara nga gjykata në vendimin e dënimit, sepse fajësia e kërkuesit është e provuar edhe me prova të tjera. Por

pavarësisht se prova e re nuk provon pafajësinë e kërkuesit, gjykata e apelit ka vlerësuar se, në rastin konkret, ka vend për zbatimin e dispozitës penale favorizuese ndaj tij. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim ligjin si pasojë e moszbatimit të nenit 3, pika 3, të KP-së ndaj kërkuesit, pasi pozita procedurale e tij vërtet nuk ka ndryshuar, por pranimi i kërkesës së tij për rishikimin e vendimit penal sjell futjen e gjykimit me procedurë të zakonshme, duke i dhënë atij të drejtën e ankimit dhe të kontrollit gjyqësor nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit (*shih faqet 11, 12, 13 dhe 15 të vendimit nr.10-2018-1993 (444), datë 31.10.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës*).

42. Për sa i takon procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal ka argumentuar fillimisht se karakteri i jashtëzakonshëm i rishikimit del qartë nga vendosja e tij si mjet ankimi jashtë dhe përtej procesit të zakonshëm penal, ndërkohë që ankimi dhe rekursi si mjete ankimi në KPP, ndryshe nga rishikimi, janë përfshirë në fazat e procesit penal të gjykimit si mjete shteruese që çojnë në dhënien e një vendimi gjyqësor përfundimtar me pasojë zgjidhjen e çështjes. Kolegji Penal ka mbështetur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe qasjen e saj ndaj vendimit nr. 4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit neni 3, pika 3, i KP-së zbatohet vetëm gjatë fazave të gjykimit në të tria shkallët e gjykimit, për sa kohë që vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Jashtë këtij përcaktimi kjo dispozitë nuk mund të zbatohet në raste të tilla, siç është rishikimi i vendimit të formës së prerë, ku si vendimi dhe i dënuari ruajnë të njëjtën pozitë procedurale. Po sipas tij, gjykata e apelit, gjatë gjykimit të kërkesës për rishikim, nuk mund të tejkalojë përcaktimet e normave ligjore që rregullojnë gjykimin e këtij rasti dhe as të vlerësonte kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve të mëparshme, në aspektin e vlerësimit të provave të shqyrtuara në këto gjykime, cilësimit juridik të veprave penale, si dhe caktimit të dënimit. Po sipas Kolegjit Penal, në rastin në shqyrtim, shkak i rishikimit ka qenë “prova e re”, e dalë pas vendimit të formës së prerë dhe e parashikuar si e tillë nga neni 450, shkronja “c”, i KPP-së, ndaj, në këto kushte, gjykata e apelit duhet të respektojë në mënyrë rigoroze vetëm marrjen e provës që ka vënë në lëvizje procesin, duke e vlerësuar atë në unitet me provat që ishin shqyrtuar në proceset e gjykimeve të mëparshme. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit ka gabuar në lidhje me zbatimin e nenit 3, pika 3, të KP-së, në raport me momentin kohor të zbatimit të tij, si dhe për shkak të fazës së zbatimit të tij, siç është shprehur edhe vetë dispozita, duke vepruar kështu në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 23, 28, 29, 30 dhe 35 të vendimit nr. 00-2023-1717 (282), datë 31.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

43. Bazuar në sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se, në rastin objekt gjykimi, procesi i rishikimit të vendimit penal të formës së prerë është zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pasi paraprakisht nga Gjykata e Lartë është vlerësuar se kërkuesi ka paraqitur një provë të re dhe thelbësore në kuptim të ligjit, e cila nuk rezultonte të ishte marrë në shqyrtim në gjykimin penal të zhvilluar kundër tij dhe, si rrjedhim, ajo e ka konsideruar të nevojshme që kjo provë e re t'i nënshtrohej shqyrtimit nëpërmjet debatit gjyqësor dhe të vlerësohej së bashku me provat e tjera të shqyrtuara në gjykimin e mëparshëm.

44. Gjykata e shkallës së parë e ka marrë në vlerësim provën e re, në bazë të së cilës është pranuar rishikimi i vendimit penal të formës së prerë dhe duke shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të parashtruara në kërkesën e rishikimit ka dalë në përfundimin se ajo nuk ndryshonte faktin penal për të cilin ishte dënuar kërkuesi, pra nuk provonte se vendimi i mëparshëm ishte i gabuar. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka pranuar aplikimin e neni 3, pika 3, të KP-së gjatë procesit të rigjyimit të çështjes, ndërkohë që gjykata e apelit e ka zbatuar dispozitën penale favorizuese, qëndrim i cili nuk është mbështetur nga Gjykata e Lartë, e cila, në të njëjtën linjë me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, ka vënë në dukje citimin e vendimit të unifikuar nr. 4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit neni 3, pika 3, i KP-së zbatohet vetëm gjatë fazave të gjyimit në të tria shkallët e gjyimit, për sa kohë që vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Jashtë këtij përcaktimi kjo dispozitë nuk mund të zbatohet, siç ishte rasti i rishikimit, ku si vendimi dhe i dënuari ruajnë të njëjtën pozitë procedurale.

45. Në këndvështrim të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve, nisur nga fakti se ndryshimi i ligjit nuk mund të shërbejë si shkak për rishikim, sikurse pranon edhe kërkuesi, çmon se gjykatat e zakonshme kanë rivlerësuar faktin penal nën dritën e provës së re të paraqitur dhe kanë arritur në përfundimin se ajo nuk provon se vendimi i formës së prerë është i gabuar. Po kështu, gjatë procesit të rishikimit, në përputhje me nenin 453, pika 4, të KPP-së, kërkuesi ka ruajtur të njëjtën pozitë procedurale, pra nuk e ka humbur statusin e të dënuarit, prandaj në kontekstin e këtyre rrethanave në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, dënimi i dhënë ndaj tij nuk përbën dënim të ri. Bazuar në këto konsiderata nuk duket se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të jetë i paarsyeshëm, ndaj pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues është haptazi i pabazuar.

46. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.